

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK
)**

Komisioni i Përherëshëm i “Shëndetësisë, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazise Gjinore”

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Nr ___, datë 29.04. 2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit Datë 30.04.2026, relacionit e dokumentat

P/VENDIM “PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2022–2024.

BAZA LIGJORE:Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, si dhe në kuadër të zbatimit të politikave për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, bazuar në Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2022–2024, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak

Situata aktuale e funksionit a)

Ky relacion paraqitet për shqyrtim në Këshillin Bashkiak, në kuadër të raportimit mbi zbatimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2022–2024, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 78, datë 30.09.2022. Sipas raportit të monitorimit, vlerësimi është kryer për periudhën tetor 2022 – dhjetor 2025, duke marrë në konsideratë faktin se miratimi i planit është bërë në fund të tremujorit të tretë të vitit 2022 dhe, për rrjedhojë, një pjesë e masave dhe veprimeve të planifikuara kanë vijuar të zbatohen edhe gjatë vitit 2025.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Shëbimit Social

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh: Monitoron Komisioni i “Shëndetësisë, Mirëqënies Sociale, Rinisë dhe Barazise Gjinore”, dhe Këshilli Bashkiak çdo muaj dhe sa herë e sheh ai të nevojshme

Impakti social / grupet që preken:

Raporti ka për qëllim të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në plan, të evidentojë arritjet, sfidat dhe boshllëqet gjatë zbatimit, si dhe të ofrojë orientime për përmirësimin e politikave vendore në fushën e barazisë gjinore në periudhën në vijim. Në përmbajtjen e tij, raporti analizon progresin sipas katër fushave kryesore të ndërhyrjes: forcimin e kuadrit institucional për barazinë gjinore, reduktimin e stereotipeve gjinore dhe diskriminimit, fuqizimin ekonomik dhe social të grave, si dhe forcimin e mekanizmave për parandalimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë:

A është objekt i konsultimit Publik: Jo

Komisioni i Përhershëm për “ Shëndetësisë, mirëqënies sociale, rinisë dhe barazise gjinore” , i mbledhur me datën 29.04.2026, shqyrtoi projekt vendimin , relacionet dhe dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

P/VENDIM “PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2022–2024.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni e me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit (3) projektakte në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit
 - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
 - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

Anila Lami Rogjari Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Agonit Kulla Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

29.04.2026.